



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR

Gjirokastrë më:04.09.2026

**SHPALLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË KATEGORISË SË ULËT DHE TË
MESME DREJTUES NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE OSE
NGRITJES NË DETYRË**

Lloji i diplomës “Master i shkencave” / “Master Profesional”
të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me
kohëzgjatje normale 2 vite akademike, *në Agronomi, Gjeodezi ose shkencat
ekonomike* ose diploma të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të
lartë.

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe
të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 “Për
plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, **Këshilli i Qarkut
Gjirokastrë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtje se Tokes**, shpall procedurat e lëvizjes
paralele ose të ngritjes në detyrë për pozicionin:

- **1 (një) Përgjegjës sektori për Bashkitë Përmet - Këlcyrë, Kategoria e Pagës
III-2**

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori
për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në
përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione
vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së
ngritjes në detyrë për plotësimin e vendeve të lirë të kategorisë së ulët dhe të
mesme drejtues .

**Për të dy procedurat (LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË**

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	13 Shtator 2026
Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË:	18 Shtator 2026

Adresa: Rruga “Ismail Kadare”, Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokastr@yahoo.com

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipër është:

1. Drejtimi i punës së përditshme të Zyrës së DAMT.
2. Krijimi, administrimi dhe përditësimi i arkivit elektronik dhe fizik të të dhënave.
3. Menaxhimi i bazës së të dhënave kadastrale dhe sistemi i saj në formatin digjital.
4. Organizimi i masave për zbatimin e programeve mbrojtëse për tokën.
5. Ruajtja dhe inventarizimi i dokumentacionit kadastral ekzistues.
6. Grumbullimi dhe sistematizimi i dokumentacionit të ri kadastral.
7. Ndjekja e evidentimit të tokave bujqësore të pakultivuara dhe të dhëna me qira.
8. Përgatitja e "evidencës së gjendjes dhe ndryshimit të kategorive të resurseve".
9. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve dhe dhënia e sqarimeve.
10. Lëshimi i vërtetimeve për pronësinë, bonitetin dhe skemat kadastrale.
11. Kryerja e kontrollit të gjendjes së rrjetit kullues, veprave antierozive dhe ujore.
12. Kontrolli për depozitim të paligjshëm të mbetjeve në tokë bujqësore.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë";
- ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- d) Përvojë pune në administrim tokës, kadastrë ose një fushë të ngjashme teknike.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

1. Diplomë "Master i shkencave" / "Master Profesional" të përfutur në fund të studimeve ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në Agronomi Gjeodezi ose shkencat ekonomike ose diploma të barazvlefshme me to sipas legjislacionit arsimit të lartë.
2. Njohuri të thella të sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) dhe të bazave të dhënave. Aftësi menaxhimi ekipi dhe organizimi. Njohuri të mira të legjislacionit në fuqi për administrimin dhe mbrojtjen e tokës.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, dokumentat si më poshtë:

- a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
a- <http://ëëë.dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/219-udhezime-dokumenta>
- b-Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

- c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, brenda datës 13.09.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 14.09.2026 pas verifikimit paraprak të kandidatëve Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, të faqja e internetit e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si dhe në stenden e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
2. Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”;
3. Kodi i Procedures Civile, i ndryshuar;
4. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë,
5. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,
6. Ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës, i ndryshuar”;
7. V.K.M Nr.121, datë 17.02.2011 “Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtje së tokës në Komuna/Bashki”
8. Ligjin Nr. 9244, datë 17.06.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen për dokumentacionin e dorëzuar me 40 pike: 20 pike për përvojën 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pike për

Adresa: Rruga “Ismail Kadare”, Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

çertifikimet pozitive. Totali i pikeve per kete vleresim eshte 40 pike.

Kandidatet gjate intervistes se strukturuar me goje do te vleresohen ne lidhje me:

- a- Njohurite, aftesite, kompetencen ne lidhje me pershkrimin e pozicionit te punes;
- b- Eksperiencen e tyre te meparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrierren.

Totali i pikeve per kete vleresim eshte 60 pike.

Ne perfundimin te vleresimit perzgjidhet kandidati, i cili renditet i pari nder kandidatet qe kane mare te pakten 70 pike.

Me shume detaje ne lidhje me vleresimin me pike, metodologjine e shperndarjes se pikeve, menyren e llogaritjes se rezultatit perfundimtar i gjeni ne Udhezimin nr. 2 dt. 27.03.2015 te Departamentit te Administrates Publike "www.dap.gov.al"

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në stenden si dhe ne faqen e internetit e Këshillit të Qarkut.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Këtë Informacion do ta merrni pranë Këshillit të Qarkut, duke filluar nga data 14.09.2026.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët pjesë të shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 26, Kreut V, të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet qe duhet te plotesoje kandidati ne proceduren e ngritjes nedetyrë jane :

- a) Te jetenëpunës civil i konfirmuar;
- b) Te mos ketë masë disiplinore në fuqi ;
- c) Te ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë" ;
- d) Të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil;
- e) Të përmbushë kriteret e vecanta të përcaktuara në shpalljen per konkurrim.
- f) Përvojë pune në administrim tokës, kadastrë ose një fushë të ngjashme teknike.

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon :

1. Diplomë “Master i shkencave” / “Master Profesional” të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në Agronomi, Gjeodezi ose shkencat ekonomike ose diploma të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.
2. Njohuri të thella të sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) dhe të bazave të të dhënave. Aftësi menaxhimi ekipi dhe organizimi. Njohuri të mira të legjislacionit në fuqi për administrimin dhe mbrojtjen e tokës.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://ëëë.dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
- h- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 18.09.2026 në adresën: Rruga “Ismail Kadare”, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 21.09.2026 , Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” te faqja e internetit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si dhe në stenden e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimi në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, për shkaqet e moskualifikimit .

Adresa: Rruga “Ismail Kadare”, Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

1. Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
2. Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë";
3. Kodi i Procedures Civile, i ndryshuar;
4. Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
5. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë
6. Ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës, i ndryshuar";
7. V.K.M Nr.121, datë 17.02.2011 "Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtje së tokës në Komuna/Bashki"
8. Ligjin Nr. 9244, datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen perkatesisht:

- a- 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar
- b- Intervisten e strukturuar me gojë që konstiton në motivimin , aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën , 40 pikë.
- c- Vlerësimi me shkrim, 40 pikë.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" faqja zyrtare e internetit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si dhe në stenden e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet.

Kandidatë fitues janë kandidatët që kanë marrë mbi 70 pikë (70% të pikëve), duke u renditur nga kandidati me rezultatin më të lartë.

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

Me shume detaje ne lidhje me vleresimin me pike, metodologjine e shperndarjes se pikeve, menyren e llogaritjes se rezultatit perfundimtar i gjeni ne Udhezimin nr. 2 dt. 27.03.2015 te Departamentit te Administrates Publike "www.dap.gov.al"

Për sqarime të mëtejshme mund të na kontaktoni në adresën e e-mail keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com ose në adresën: Rruga "Ismail Kadare", Këshilli i Qarkut Gjirokastër

KRYETAR
Dino Selimi



Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com